



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 468/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimic dhe Feriđ Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK) me seli në Malishevë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) në Malishevë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK)

Arsyetim

Subjektit Politik PDK, ka parashtruar ankesë kundër Subjektit Politik LVV, duke pretenduar se në orën 14:00 në Drenoc në afërsi të VV 3008/A në oborrin e shkollës fillore “Bajram Curri”, aktivist dhe simpatizant të LVV kanë provokuar dhe fyer aktivistët e PDK-së të cilët kanë qenë në cilësi të vëzhguesit zyrtar. Sipas parashtruesit të ankesës policia ka ndërhyrë dhe ka larguar aktivistët dhe simpatizantët e LVV nga oborri i shkollës.

Shtabi Zgjedhor i Degës së PDK-së dënon provokimin e LVV-së dhe kërkon që institucionet përkatëse të ndërmarrin të gjitha masat në mënyrë që qytetarët të votojnë të qetë

Më 12 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga PDK, duke pretenduar se në ditën e zgjedhjeve simpatizantët dhe aktivistët të LVV-së kishin provokuar dhe fyer simpatizantët e PDK-së.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e PDK-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur provokime në ditën e zgjedhjeve.

PZAP-i konsideron që PDK nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 468/2010 më datën 14.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

